

*Zyra Juridike*

*Zyra e Informacionit*

Nr. 2400/Prot

dt. 18.09.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
PËRMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"**

Nr.1106/Prot.

Tiranë, me dt.14/09/2020

**Lënda:** Kërkohej shpallja e "Vendimit për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të urdhërit të ekzekutimit"

**Drejtuar :** Bashkia e Qytetit

**DELVINË**

Të nderuar zotërinj!

Në vijim të procedurave të ndjekura për efekt të ekzekutimit të urdhërit të ekzekutimit **Nr.118 Akti, datë; 19.07.2000, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë**, në ngarkim të palës debitore **Metli Ajdini**, ju sqaroj se:

Zyra përmbare, në mbështetje të nenit 133 të K. Pr. Civile, ka bërë shpalljen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar. Megjithëse, pala debitore ka marrë dijeni dhe nuk ka vepruar për shlyerjen e detyrimit sipas afatit të përcaktuar në nenin 517 të K. Pr. Civile. Në këto kushte, kur pala debitore nuk ka ekzekutuar titullin ekzekutiv në mënyrë vullnetare, në mbështetje të nenit 519 K.Pr.Civile, ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe për këtë arsye referuar neneve 527,529 të K.Pr.Civile, është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros mbi llogaritë e palës debitore.

Sa sipër, në mbështetje të nenit 133 të K.Pr.Civile, kërkoj që nga ana e institucionit tuaj si Bashkia e Qytetit Delvinë, të bëni afishimin e "Vendimit për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të urdhërit ekzekutiv, nr.862/prot, datë 16.07.2020 , "Urdhër për vendosjen e masës së sekuestros në llogari nr.863/prot, datë16.07.2020 (bashkangjitur kësaj shkrese) në ngarkim të palës debitore **Metli Namik Ajdini, i datëlindjes 1954.**

Për veprimet apo mosveprimet tuaja, duhet t'na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor. Personat që do të bëhen pengesë, do të përgjigjen në bayë të nenit 606 të K.Pr.Civile(parag II), që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Me respekt,

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT**

**Ensola S. KUÇI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
PERMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"

Nr.862/Prot.

Tiranë, me dt.16/07/2020

**V E N D I M**

**Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshem të "Urdhërit të Ekzekutimit"**

Unë, përmbaruese gjyqësore private Ensola Skënder Kuçi, me Nr. çertifikate 225, regjistruar në QKR me Nr. NIPT:L51801021A, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.512/Regj, bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.118 Akti, datë; 19.07.2000, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë,

**KONSTATOVA:**

Se me datë; 03.02.2020 është depozituar pranë përmbarueses gjyqësore private "Ensola Kuçi", kërkesa e kreditorit, Agjencia e Trajtitimit të Kredive, së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Marrëveshje Huaje, datë 27.03.1996, me palë dhe objekt:

**Kreditor : Agjencia e Trajtitimit të Kredive**

**Debitor : Metli Ajdini**

**Objekti : Kthim Shume**

Praktika përmbarimore ka qënë në ekzekutim pranë Zyrës përmbarimore "Bailiff Services Matani & Co" sh.p.k. Për rrjedhojë, nga ana e zyrës përmbarimore është dërguar urdhër për vendosjen e masës së sekuestros për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të palës debitore. Më pas Studio përmbarimore Services Matani & Co" sh.p.k me kërkesë të palës kreditore Agjencia e Trajtitimit të Kredive ka transferuar dosjen përmbarimore së bashku me dokumentacionin (origjinal) pranë Zyrës Përmbarimore "Ensola Kuci". Për rrjedhojë, është marrë vendimi për vazhdimin e ekzekutimit të urdhërit të ekzekutimit.

Zyra përmbarimore, në mbështetje të nenit 517 të K. Pr. Civile, ka dërguar në drejtim të palës debitore njoftimin për vazhdimin e ekzekutimit të titullit të ekzekutimit. Megjithese pala debitore ka marrë dijeni, nuk ka vepruar për ekzekutimin e urdhërit të ekzekutimit në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 517 të K. Pr. Civile.

Në këto kushte, kur pala debitore nuk ka ekzekutuar titullin ekzekutiv në mënyrë vullnetare, në mbështetje të nenit 519 K.Pr.Civile, duhet të merret vendimi për kalimin e titullit ekzekutiv në ekzekutim të detyrueshem.

**Sa sipër, në mbështetje të nenit 519 të K. Pr. Civile:**

**V E N D O S A :**


Fillimin e ekzekutimit të detyrueshem për ekzekutimin e urdhërit të ekzekutimit Nr.118 Akti, datë; 19.07.2000, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë, lëshuar për

Adresa: Rr."Teodor Keko", Pall GBA Konstruksion, Kati 3, Tiranë Cel.0682000133, email:kuciensola@gmail.com.

titullin e ekzekutimit, Marrëveshje Huaje, datë 27.03.1996, në ngarkim të palës debitore Metli Ajdini.  
Vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të palës debitore **Metli Namik Ajdini, i datëlindjes 1954**, për shumën e detyrimit në masën prej **2,571,899 Lekë (principal + interesa+shpenzime gjyqi) dhe tarifën e shërbimit përmbarimor në masën prej 246,901 lekë me tvsh.**

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT**

**Ensola KUÇI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
PERMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE "ENSOLA KUÇI"

Nr.863/Prot.

Tiranë, me dt.16/07/2020

URDHËR  
VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

Drejtuar : Bankave të Nivelit të Dytë

TIRANË

Drejtuar: Debitori, Metli Namik Ajdini

Adresa : Fshati Kalas

DELVINË

Unë, përmbaruese gjyqësore private Ensola Skënder Kuçi, me Nr. çertifikate 225, regjistruar në QKR me Nr. NIPT:L51801021A, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.512/Regj. bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Nr.118 Akti, datë; 19.07.2000, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**KONSTATOVA:**

Se me datë; 03.02.2020 është depozituar pranë përmbarueses gjyqësore private "Ensola Kuçi", kërkesa e kreditorit, Agjencia e Trajtimit të Kredive, së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit, lëshuar për Titullin Ekzekutiv, Marrëveshje Huaje, datë 27.03.1996, me palë dhe objekt:

**Kreditor : Agjencia e Trajtimit të Kredive**

**Debitor : Metli Ajdini**

**Objekti : Kthim Shume**

Praktika përmbarimore ka qënë në ekzekutim pranë Zyrës përmbarimore "Bailiff Services Matani & Co" sh.p.k. Për rrjedhojë, nga ana e zyrës përmbarimore është dërguar urdhër për vendosjen e masës së sekuestros për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të palës debitore. Më pas Studio përmbarimore Services Matani & Co" sh.p.k me kërkesë të palës kreditore Agjencia e Trajtimit të Kredive ka transferuar dosjen përmbarimore së bashku me dokumentacionin (original) pranë Zyrës Përmbarimore "Ensola Kuci". Për rrjedhojë, është marrë vendimi për vazhdimin e ekzekutimit të urdhërit të ekzekutimit.

Zyra përmbarimore, në mbështetje të nenit 517 të K. Pr. Civile, ka dërguar në drejtim të palës debitore njoftimin për vazhdimin e ekzekutimit të titullit të ekzekutimit. Megjithese pala debitore ka marrë dëgjim, nuk ka vepruar për ekzekutimin e urdhërit të ekzekutimit në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 517 të K. Pr. Civile. Në këto kushte, kur pala debitore nuk ka ekzekutuar titullin ekzekutiv në

Adresa: Rr."Teodor Keko", Pall GBA Konstruksion, Kati 3, Tiranë Cel.0682000133, email:kuciensola@gmail.com.

mënyrë vullnetare, në mbështetje të nenit 519 K.Pr.Civile, ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Sa sipër, për efekt të ekzekutimit të titullit ekzekutiv duhet të kryhet bllokimi i llogarisë bankare, depozitave apo kredi të debitorit tek të tretët, në shumën e mëposhtme, si dhe në zbatim të neneve 527,581,589,593 e në vijim të K.Pr.Civile dhe Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë Nr.2 dt.27.03.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në Bankë".

### **U R D H Ë R O J ;**

Vendosjen e masës së sekuestros mbi llogarinë e palës debitore **Metli Namik Ajdini, i datëlindjes 1954**, për shumën e detyrimit në masën prej **2,571,899 Lekë (principal + interesa+shpenzime gjyqi) dhe tarifën e shërbimit përmbarimor në masën prej 246,901 lekë me tvsh.**

Sekuestro duhet të vendoset në zbatim të Titullit Ekzekutiv Vendim Nr.118 Akti, datë; 19.07.2000, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke respektuar rradhën e preferimit, bazuar në nenin 605 të K.Civil.

Sekuestro duhet të vendoset mbi çdo llogari, depozitë në varësi të llojit të valutës gjëndje të palës debitore.

Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

*Bashkëngjitur po ju dërgojme një kopje të Urdhërit të Ekzekutimit Vendim Nr.118 Akti, datë; 19.07.2000, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Sarandë*

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT**

**Ensola KUÇI**

